

Objekti kryesor i këtij prokurimi është mirëmbajtja e Sistemeve të integruara të informacionit të Bashkisë Shkodër (Bashkisë Qendër ,5 Lagjet dhe 10 njësitë Administrative të saj).

Specifikimet teknike janë përgatitur duke patur parasysh fondin që është vënë në dispozicion nga Bashkia Shkodër sipas VKB Nr.55 datë 29.12.2023 “ Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar për vitet 2024-2026 të Bashkisë Shkodër ”

Në vijim janë dhënë të plota këto specifikime, të cilat përshkruajnë si do të realizohet ky shërbim.

1. Mirëmbajtje për Smart Processes Enterprise - Programi i SiZ1N për Bashkinë Qendër, 5 Lagjet dhe 10 Njësitë Administrative

Qëllimi i këtij shërbimi, është mirëmbajtja e Sistemit të Integruar të Zyrave me Një Ndalesë (SiZ1N) i cili është implementuar në Bashkinë Shkodër dhe Njësitë e saj Administrative.

Sistemi i Integruar i Zyrave me Një Ndalesë SiZ1N është i shtrirë në Bashkinë Qendër, në Njësitë Administrative: Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, Guri i Zi, Postribë, Pult, Rrethinat, Shalë, Shosh, Velipojë si dhe në 5 Lagjet. Përmes SiZ1N, Bashkia Shkodër ofron 69 shërbime administrative ndaj qytetarëve të saj, tashmë të konsoliduara në bazë ligjore, rrjedhë pune (workflow), dokumenta aplikimi dhe afate kohore për ofrimin e tyre. Sistemi është ndërtuar mbi platformën Smart Processes. Fluksi i kërkesave për shërbime të ndryshme administrative, përmes këtij sistemi është në një numër të konsiderueshëm ditor në bashkinë qendër dhe njësitë administrative të saj ku sistemi është i shtrirë.

Si i tillë, ky sistem nuk toleron ndërprerje të funksionimit gjatë orarit të punës, qoftë edhe të planifikuar për shkak azhurnimesh versioni (upgrade), azhurnime shërbimesh (update) apo modifikime të ndryshme.

Shërbimet administrative të ofruara përmes këtij sistemit SiZ1N ndaj qytetarëve (liçenca, çertifikata, leje, vërtetime, bursa, kërkesa, ankesa, etj) në varësi të sektorëve, detyrave dhe funksioneve që ata kryejnë duhet të jenë funksional 24orë/në 7 ditë.

Objekti kryesor i këtij shërbimi, është mirëmbajtja e Sistemit të Integruar i Zyrave me Një Ndalesë (SiZ1N), me qëllim sigurimin e vazhdimësisë së punës mbi 99.9% në të gjithë komponentët dhe shërbimet e ofruara nga këto sisteme.

Kërkesat Teknike:

Kërkesat për mirëmbajtjen e sistemit të informacionit SiZ1N konsistojnë në plotësimin e komponentëve të mëposhtme:

1. Ofruesi i shërbimit duhet të sigurojë upgrade dhe update të sistemit informatik sa herë që të jetë e nevojshme.
2. Ofruesi i shërbimit duhet të sigurojë asistencën e ruajtjes së kopjes së sigurtë të të dhënave (Backup).
3. Ofruesi i shërbimit duhet të sigurojë hostimin dhe sinkronizimin e platformes SiZ1N të ngritur në platformën Smart Processes dhe me Aplikacionin Mobile.
4. Shërbimet e Përmirësimit apo Modifikimit të sistemit. OE duhet të kryejë përmirësime

apo modifikime të sistemit që përfshijnë kryesisht:

- Azhornimin, përmirësimin dhe modifikimin e moduleve ekzistuese.
- Pastrimin dhe konvertimin e të dhënave.
- Modifikimin e formularëve të përdorur sipas kërkesave ligjore.
- Përmirësimin e performancës së proceseve aktuale të sistemeve.
- Përmirësimin e raporteve aktuale që prodhohen nga sistemi sipas kërkesave të institucionit.
- Shtimin e shërbimeve të reja në varësi të ndryshimeve ligjore, delegimit të kompetencave të reja, ristrukturimit organizativ të institucionit, etj.
- Përmirësimin e performancës së proceseve të shërbimeve aktuale.
- Përmirësimin dhe shtimin e raporteve që prodhohen nga SiZIN.
- Rikonfigurim i rrjedhës së punës për shërbimet, në varësi të ndryshimeve të Rregullores së Procedurave Administrative të Bashkisë Shkodër për ofrimin e shërbimeve administrative ndaj qytetarëve përmes ZiIN.

2. Mirëmbajtje e Liçensës së Programit SiTTV për Bashkinë Qendër dhe nëNjësitë Administrative të saj.

Sistemi SiTTV ofron shërbimet për taksapaguesit si dhe për vetë administratën e Bashkisë bazuar në Paketën Fiskale në fuqi.

Përmes këtij sistemi informacioni është bërë e mundur:

1. Dokumenti i Paktës Fiskale
2. Qasja e përdoruesve në aplikacion
3. Regjistri i Bizneseve
4. Llogaritja automatike e detyrimeve dhe gjenerimi i njoftimeve
5. Gjenerimi automatik i faturave
6. Regjistrimi i pagesave
7. Faturat për Individet
8. Verifikimi automatik për shlyerjen e detyrimeve vendore në SiZIN

Disponueshmëria e Sistemit të Taksave është shumë e rëndësishme. Sistemi është ndërtuar mbi platformën Smart Processes. Shërbimet e ofruara ndaj taksapaguesve (pagesat, faturat e detyrimeve, llogaritje e detyrimeve, etj.) nga sistemi SiTTV, në varësi të sektorëve, detyrave dhe funksioneve që ata kryejnë duhet të jenë funksional 24orë/në 7 dite.

Objekti kryesor i këtij shërbimi, është mirëmbajtja e Sistemit të Informacionit (SiTTV) për mbledhjen e Taksave dhe Tarifave Vendore në çdo komponent të tij me qëllim sigurimin e vazhdimësisë së punës mbi 99.9% në të gjithë komponentët dhe shërbimet e ofruara nga këto sisteme.

Kërkesat Teknike:

Kërkesat për mirëmbajtjen e sistemit të informacionit SiTTV konsistojnë në plotësimin e komponentëve të mëposhtme:

1. Ofruesi i shërbimit duhet të sigurojë upgrade dhe update të sistemit informatik sa herë që të jetë e nevojshme.
2. Sistemi i SiTTV duhet të funksionojnë bazuar në platformën web Smart Processes.
3. Ofruesi i shërbimit duhet të sigurojë asistencën e ruajtjes së kopjes së sigurtë të të dhënave (Backup).
4. Shërbimet e Përmirësimit apo Modifikimit të sistemit. OE duhet të kryejë përmirësime apo modifikime të sistemit që përfshijnë kryesisht:
 - Azhornimin, përmirësimin dhe modifikimin e moduleve ekzistuese.
 - Pastrimin dhe konvertimin e të dhënave.
 - Modifikimin e formularëve të përdorur sipas kërkesave ligjore.
 - Përmirësimin e performancës së proceseve aktuale të sistemeve.
 - Përmirësimin e raporteve aktuale që prodhohen nga sistemi sipas kërkesave të institucionit.
 - Shtimin e funksionaliteteve të reja në varësi të ndryshimeve ligjore, delegimit të kompetencave të reja, ristrukturimit organizativ të institucionit, etj.
 - Përmirësimi i performancës së proceseve të shërbimeve aktuale.
 - Përmirësimi dhe shtimi i raporteve që prodhohen nga SiTTV.
5. Duhet të sigurohet në vazhdimësi:
 - a. Trajnimi mbi funksionalitetet egzistuese dhe të reja të sistemit;
 - b. Trajnimi mbi konfigurimin dhe monitorimin e sistemit;
 - c. Trajnimi mbi sistemin e raportimit.
6. Ofruesi i shërbimit duhet të sigurojë asistencën teknike për specialistët TIK në rast të përmirësimit të teknologjisë (hardware), në raste azhornimesh të platformës Smart Processes duke i asistuar në riinstalimet e nevojshme të sistemit.
7. OE duhet të ofrojë suport në rast se një faktor i brendshëm apo i jashtëm afekton sistemin.
8. Modifikimi i funksionaliteteve të sistemit të informacionit SiTTV si:
 - Përshtatja e funksionalitetit të sistemit bazuar në ligjet dhe procedurat e reja;
 - Përmirësimi i efikasitetit në kohë;
 - Aplikimi i funksionaliteteve të reja.
9. Të mbështesë specialistët IT, në menaxhimin e përdoruesve të sistemit ku përfshihet krijimi i përdoruesve të rinj, modifikimi i përdoruesve ekzistues në sistem, si dhe të drejtat e aksesit të tyre (menaxhimi i roleve).
10. OE duhet të ofroje suport aktiv 8 ore nga e Hena ne te Premten (08:00 – 16:30).
11. OE duhet të kryejë vizita konsultative në të paktën 2 herë në muaj në Bashkinë Shkodër.

3. Mirëmbajtje e platformës on-line Transparenca e Buxhetit

Platforma “Transparenca e Buxhetit” ofron disa funksionalitete në kuadër të rritjes së transparencës së bashkisë Shkodër ndaj qytetarëve dhe bizneseve në zbatim të buxhetit në vite

kalendarike. Përdorimi i kësaj platforme ka lehtësuar qasjen e publikut ndaj informacionit për të ardhurat vjetore të bashkisë, shpenzimet dhe investimet e kryera si edhe ka ndikuar në përfshirjen e qytetarëve dhe bizneseve në vendimmarrje.

Objekti kryesor i këtij shërbimi, është mirëmbajtja e platformës on-line **Transparenca e Buxhetit** në çdo komponent teknik të saj, me qëllim sigurimin e vazhdimësisë së punës mbi 99.9% të shërbimeve e ofruara prej saj.

Kërkesat Teknike:

Platforma Transparenca e Buxhetit duhet të sigurojë vazhdimësinë e funksionaliteteve të 3 Moduleve:

- 1. Shpenzimet**
- 2. Të Ardhurat e Veta Vendore**
- 3. Taksat e Mia**

Moduli i Shpenzimeve:

- Duhet të jetë i ndryshueshëm sipas viteve kalendarike, në përputhje të programeve buxhetore dhe aktiviteteve të parashikuara në Buxhetin e vitit respektiv të Bashkisë Shkodër.
- Duhet të ofrojë mundësinë e detajimit të këtij moduli në të gjithë Programet Buxhetore me të cilat buxheton aktualisht Bashkia Shkodër dhe në detajime të mëtejshme të nevojshme konform ndryshimeve që mund të pësojnë këto programe në të ardhmen.
- Secili program buxhetor duhet të mund të detajohet në aktivitetet (pa limit numri) e parashikuara në buxhetin vjetor.
- Aktivitetet duhet të gjeolokalizohen në hartën e integruar në platformë ekzaktësisht në njësinë administrative ku zbatohet investimi/shpenzimi i parashikuar
- Për çdo aktivitet duhet të mundësohet vendosja e të dhënave në formën open data si:
 - Ku investohet?
 - Sa para janë planifikuar?
 - Sa para janë shpenzuar?
 - Kush financon?
 - Kush e zbaton?
 - Afatet e realizimit?
 - Cila Njësi Administrative është përfituese?
 - Në cilën fazë është aktiviteti (planifikuar/ në proces/ zbatuar)?
 - Mundësi integrimi të fotove dhe videove të realizimit të shpenzimit/investimit
 - Mundësi e bashkëlidhjes së fishprojektit të parashikuar në lidhje me këtë aktivitet në buxhet
 - Mundësi e bashkëlidhjes së kontratës së nënshkruar nga Bashkia Shkodër dhe Operatorit Ekonomik që do të jetë fitues për realizimin aktiviteti përkatës
 - Mundësi e dhënies së Sugjerimeve nga qytetarët (e-pjesëmarrje) e cila do të drejtohet nga sistemi adresës zyrtare të bashkisë Shkodër

info@bashkiashkodër.gov.al dhe më pas duhet të procesohet nga zyra përgjegjëse duke u gjurmuar përmes platformës.

- Për çdo program buxhetor duhet të ofrohet dhe lista e aktiviteteve totale me informacionin:
 - Sa para janë parashikuar për çdo aktivitet?
 - Sa para janë shpenzuar për çdo aktivitet?
 - Si dhe të përmbledhura në total për programin buxhetor përkatës.
- Paratë e parashikuara për investime/shërbime dha ato të realizuara në çdo kohë të vitit duhet të kemi gjithashtu të publikuar në total në rang Bashkie.

Moduli i të Ardhurave të Veta Vendore:

- Duhet të jetë i ndryshueshëm sipas viteve kalendarike, në përputhje të të ardhurave vendore të vitit respektiv të Bashkisë Shkodër
- Duhet të ofrojë mundësinë e detajimit të të ardhurave në të gjithë Njësitë Administrative dhe të atyre të transferuara nga pushteti qendror
- Të ardhurat duhet të gjeolokalizohen në hartën e integruar në platformë në njësitë administrative përkatëse
- Për çdo njësi administrative apo transferte të pushteti qendror duhet të mundësohet vendosja e të dhënave në formen open data si:
 - Sa të ardhura janë planifikuar?
 - Sa të ardhura janë realizuar?
- Në total duhet të kemi gjithashtu të publikuar të ardhurat e parashikuara dha ato të realizuara në çdo kohë të vitit.
- OE duhet të jetë në mbështetje të vazhdueshme për specialistët IT, në menaxhimin e platformës.
- OE duhet të sigurojë vazhdimësinë e platformës dhe mirëmbajtjen e saj të mbështetur në platformën Smart Processes.
- OE duhet të ofrojë suport aktiv 8 ore nga e Hena ne te Premten (08:00 – 16:30).
- OE duhet të kryejë vizita konsultative në të paktën 2 herë në muaj në Bashkinë Shkodër.

Lista e shërbimeve qe duhet të ofrojë operatori

Sherbimet
Vertetim Identiteti
Licence Taksi
Transport mallrash brenda vendit për llogari të vet
Pranim te personave me aftesi ndryshe ne institucionet rezidenciale
Kerkese per pranim te personave te moshuar ne institucionet rezidenciale
Kerkese per pranim te femijeve ne institucionet rezidenciale te perkujdesit shoqeror
Ankesë
Kërkesë për informacion

Kerkese
Vertetim Ceremonie Varrimi
Kërkesë për strehim
Konfirmim Kufizim Prone Private me Pronë Shtet
Vërtetim për shlyerje detyrimesh
Vërtetim për trajtim me ndihmë ekonomike
Vërtetim që trajtohet me pagesë për aftësi ndryshe
Vërtetim për trajtim me pagesën e shtesës së invaliditetit
Vërtetim që trajtohet me pagesë verbërie
Vërtetim që trajtohet me pagesë për paraplegjikë tetraplegjikë
Vërtetim Kujdestarie
Reduktim i takses familjare
Aplikim per pune
Vërtetim Page
Vertetim per ushtrim aktiviteti bujqesor dhe blegtoral
Kërkesë për ndihme financiare në rast djegie banese
Kerkese per perfitim ndihme ekonomike ne raste fatkeqsish natyrore
Kerkese per fotokopje dokumenti arshivor njehsuar me orgjinalin
Kerkese per kryerje punimesh
Leje per vendosje reklamash
Leje per shfrytezimin e hapesires publike
Leje për shitës ambulant
Vërtetim pagese takse infrastrukture për legalizim
Certifikate rrethqytetese
Kerkese per vendosje lojrash ne hapesire publike
Leje per veprimtari muzikore per oret e vona te nates
Licence qytetese
Vërtetim paisje me tokë bujqësore sipas ligjit Nr 7501
Vërtetim për trajtim prone mbi objektet e ndërтуara deri me 10-08-1991
Licence per tregtimin me pakice te karburanteve
Certifikate Qytetese
Autorizim Qarkullimi
Kerkese per vend parkim te rezervuar
Licence per tregtim te njesive te lendeve djegese
Transport nderkombetar udhetaresh
Licence per agjenci transport udhetaresh dhe sherbimi taksi brenda vendit
Certifikate per operacionet e transportit te udhetareve brenda vendit per llogari te vet
Licence per sherbime te rregullta te specializuara
Certifikate per sherbime te rregullta te specializuara
Licence mallra per te trete
Certifikate mallra per te trete
Certifikate nderqytetese brenda qarkut
Licence nderqytetase brenda qarkut

Licence nderqytetese ndermjet qarqeve
Certifikate nderqytetase ndermjet qarqeve
License rrethqytetese
Licence Transport Udhetarësh
Autorizime
Per perfundim te procedures se privatizimit te baneses
Kërkesë për ndricim të mjediseve publike
Leje per shfrytezim hapësire publike Stacione Plazhi
Kërkesë për mirëmbajtjen e rrugëve dhe trotuareve
Kërkesë për vërtetim regjistrimi në cerdhe ose kopësht
Vërtetim që nuk trajtohet me ndihmë ekonomike
Licencë për kryerjen e shërbimeve vajtje-ardhje
Vërtetim saktësim adrese
Certifikatë për kryerjen e shërbimeve vajtje-ardhje
Kerkese per perfitim sherbimi pa pagese ne kopesht dhe cerdhe
Vertetim Percaktim pike grumbullimi te mbetjeve urbane
Pajisje me leje per parkim per PAK
Aplikim per terheqjen e librit te udhetimit

Operatori duhet të shtojë shërbime të reja sa herë të jetë e nevojshme kur kërkohet nga drejtorja e TIK.